

ALBSIG INVEST sha

**Shoqëria Administruese
e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

**Pasqyrat financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

me raportin e Audituesit të Pavarur

Përbajtja

1. Raporti i Audituesit të Pavarur.....	i-iii
2. Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	1
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
4. Pasqyra e rrjedhjes së parasë.....	3
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	4
6. Shëni me në pasqyrat financiare.....	5

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë Albsig Invest sha.

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Albsig Invest sha. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacioni tjetër

Drejtimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin që jepet në Raportin Vjetor, të përgatitur nga drejtimi, dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi to.

Raporti ynë mbi këto pasqyra financiare nuk mbolon informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj tjetër konkluzioni që jep siguri mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe, gjatë këtij procesi, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është në mënyre materiale jo konsistent me pasqyrat financiare ose me njojuritë e përfituarë gjatë auditimit ose nëse në dukje është në mënyre materiale i gabuar.

Nëse, bazuar në punën që ne kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se ka gabime materiale në informacionin tjetër, atëherë ne duhet ta raportojmë këtë fakt. Në datën e lëshimit të këtij reporti, Shoqëria akoma nuk e ka publikuar informacionin tjetër. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me të.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvèç sa më sipër.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticitzmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njojje të kontrollit të brendshëm që ka të bejë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrëthanave, por jo për qëllime

të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyre që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Nexia AL
Auditues Ligjor
Orjana Kalaja

Tirana, Albania
29 mars 2024



ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e flukseve të parasë per periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktivet			
Paraja dhe ekuivalentë të saj	6	1,367,911	89,834
Të arkëtueshme nga Fondet	7	1,264,197	821,935
Të arkëtueshme të tjera	8	3,087,786	4,150,000
Shpenzime të parapaguara	9	839,860	839,860
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto	10	512,875	2,391,375
Investime të mbajtura deri në maturim	11	30,000,000	30,000,000
Totali i aktiveve		37,072,629	38,293,004
Detyrimet			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	12	4,049,133	2,223,626
Totali i detyrimve		4,049,133	2,223,626
Kapitali			
Kapitali i paguar	13	69,000,000	69,000,000
Humbje të mbartura		(32,930,622)	(32,773,560)
Humbje neto e periudhës		(3,045,882)	(157,062)
Totali i kapitalit		33,023,496	36,069,378
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		37,072,629	38,293,004

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese "Albsig Invest Sh.a", më 29 mars 2024 dhe u firmosën nga:

Z. Irfan LAMI

Drejtore Finance

Albsig Sh.a

Z. Elton KORBI

Administrator / Përgjimia e

Albsig Invest Sh.a



Shënimet shpjeguese në faqet 5-22 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën që mbylllet më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga tarifa e administrimit	14	13,298,318	8,838,524
Të ardhura të tjera	15	5,875,270	11,150,000
Totali i të ardhurave		19,173,588	19,988,524
 Shpenzimet			
Shpenzime për personelin	16	18,715,882	16,729,336
Shpenzime amortizimi	10	1,878,500	1,878,500
Shpenzime administrative	17	3,478,373	3,156,217
Shpenzime financiare/(të ardhura), neto	18	(1,853,285)	(1,618,467)
Totali i shpenzimeve		22,219,470	20,145,586
 Humbja përpara tatimit		(3,045,882)	(157,062)
Tatimi mbi fitimin	19	-	-
Humbja e periudhës		(3,045,882)	(157,062)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin		(3,045,882)	(157,062)

Shënimet shpjeguese në faqet 5-22 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e flukseve të parasë per periudhën që mbyllt më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimë	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional			
Humbja e periudhës		(3,045,882)	(157,062)
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime amortizimi	10	1,878,500	1,878,500
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional përpëra ndryshimeve në kapitalin qarkullues		(1,167,382)	1,721,438
<i>Rregullime për kapitalin qarkullues:</i>			
Rritje në të arkëtueshme nga fondet	7, 8	619,952	(1,469,175)
(Rritje)/ pakësim në shpenzime të parapaguara	9	-	(839,860)
Rritje në të pagueshme dhe detyrime të tjera të tjera të pagueshme	12	1,825,507	(535,359)
Fluksi i parasë neto nga aktiviteti operacional		1,278,077	(1,122,956)
 Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve të qendrueshme të patrupëzuara neto	10	-	-
Investimet	11	-	-
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese		-	-
 Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese			
Kapitali i paguar	13	-	-
(Ripagesa)/ arkëtime nga huamarrje		-	-
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet financuese		-	-
 Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë		1,278,077	(1,122,956)
Paraja dhe ekuivalentë në fillim të vitit		89,834	1,212,790
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit		1,367,911	89,834

Shënimet shpjeguese në faqet 5-22 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali akcionar	Humbja e akumuluar	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2021	69,000,000	(32,773,560)	36,226,440
Rritje kapitali	-	-	-
Humbja e periudhës	-	(157,062)	(157,062)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	69,000,000	(32,930,622)	36,069,378
Rritje kapitali	-	-	-
Humbja e periudhës	-	(3,045,882)	(3,045,882)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	69,000,000	(35,976,504)	33,023,496

Shënimet shpjeguese në faqet 5-22 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

1. Përshkrim i përgjithshëm

Albsig Invest sh.a., është Shoqëria Administruese e e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, (tani e tutje do i referohemi si "Shoqëria Administruese" ose si "Shoqeria") e themeluar në tetor të vitit 2019, dhe e licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019.

Fondi i Investimit Albsig Standard (tani e tutje do i referohemi si "Fondi i Investimit") u krijuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009, zëvendësuar me Ligjin nr. 56/2020 datë 30 prill 2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" (tani e tutje do i referohemi si "Ligji") dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019. Fondi i Investimit u krijuar nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribues mbajtës të kuotave. Fondi është një fond investimesh që investon në letra me vlerë të emetuar nga Qeveria Shqiptare.

Fondi i Pensionit Vullnetar Albsig (tani e tutje do i referohemi si "Fondi i Pensionit Albsig") u krijuar ne përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10197, date 10 dhjetor 2009 "Për Pensionet Vullnetare", zëvendësuar me Ligjin nr. 76/2023, "Për Fondet e Pensionet Privat" (tani e tutje do i referohemi si "Ligji") dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019. Fondi i Pensionit u krijuar nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribues mbajtës të kuotave. Fondi investon në letra me vlerë të emetuar nga Qeveria Shqiptare.

Banka e Tiranës është banka depozitare e Fondit Albsig e miratuar nga AMF. Banka depozitare bazuar në kërkesat e Ligjit, bën të mundur ruajtjen e aktiveve të Fondit të Investimit dhe Fondit të Pensionit, në përputhje me kërkesat e Shoqërisë Administruese.

Fondi i Pensionit Privat Smart Pension (tani e tutje do i referohemi si "Fondi i Pensionit Smart Pension") u krijuar ne përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10197, date 10 dhjetor 2009 "Për Pensionet Vullnetare", zëvendësuar me Ligjin nr. 76/2023, "Për Fondet e Pensionet Privat" (tani e tutje do i referohemi si "Ligji") dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 96, datë 28 prill 2022. Fondi i Pensionit u krijuar nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribuues mbajtës të kuotave. Fondi investon në letra me vlerë të emetuar nga Qeveria Shqiptare.

Banka Kombëtare Tregtare është banka depozitare e Fondit të Pensionit Smart Pension, e miratuar nga AMF. Banka depozitare bazuar në kërkesat e Ligjit, bën të mundur ruajtjen e aktiveve të Fondit të Investimit dhe Fondit të Pensionit, në përputhje me kërkesat e Shoqërisë Administruese.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë Administruese dhe e Fondeve është Rr. Barrikadave, Godina Qendrore e Albsig, katër 8-të, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ato u autorizuan për lëshim nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë më 29 mars 2024.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondave të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë, te cilat maten në vlerën e drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes.

c) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në monedhën shqiptare "Lek" që është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përvèç se kur është shprehur ndryshe. Monedha funksionale është monedha e ambientit primar ekonomik në të cilin Shoqëria vepron. Investimet dhe veprimet e Shoqërisë kryhen në Lek. Për rrijedhojë, Këshilli i Administrimit ka përcaktuar Lekun si monedhën funksionale të Shoqërisë.

d) Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, detyrimeve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojsësme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

e) Gjykimet kontabël dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare, kërkon qe drejtimi të bëjë gjykime, vlerësimë dhe supozime qe ndikojnë ne aplikimin e politikave kontabël dhe ne vlerën e mbartur te aktiveve dhe detyrimeve, si edhe te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga ato te vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen ne mënyrë te vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen ne periudhën kur këto vlerësimë rishikohen dhe gjithashtu në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat kontabël të rëndësishme

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme zbatohen për herë të parë në periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023:

- Reforma Tatimore Ndërkombëtare– Rregullat Modeli i Shtyllës së Dytë Ndryshime në SNK 12, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2023;
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2023;
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël – Ndryshime në SNK 8, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2023;
- Tatimi i shtyrrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që irjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2023;
- Reforma Tatimore Ndërkombëtare – Rregullat Model Shtylla e Dytë – Ndryshime në SNK 12, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 23 maj 2023.

Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara:

- Detyrimet asfatgjata me Kushtëzime – Ndryshime në SNK 1 dhe Klasifikimi i Detyrimeve si Aktuale ose Jo Aktuale – Ndryshime në SNK 1, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2024;
- Detyrimi për Qiranë në një Shitje dhe Marrje më pas me Qira Ndryshime në SNRF 16, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2024;
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit Ndryshime në SNK 7 dhe SNRF 7, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2024;
- Mungesa e shkëmbbyeshmërisë Ndryshime në SNK 21, Data e hyrjes në fuqi (zbatimi i hershëm është i mundur nëse nuk shënohet ndryshe), 1 janar 2025.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivlerësohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përvèç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u përcaktua vlera e tyre e tregut. Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezulton nga kryerja e transaksioneve të tillë si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje, përvèç instrumenteve financiare që mbahen me VDFH, të cilat njihen si një komponent i të ardhurës neto nga instrumentet financiare në VDFH.

Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqiptar për një njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
EURO	103.88	114.23
USD	93.94	107.05

b. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

i. Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria fillimisht njeh në mënyrë të rregullt, transaksionet me aktivet financiare dhe detyrimet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes ("VDFH") në datën e tregtimit, e cila është data kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e instrumentit. Aktivet e tjera financiare dhe detyrimet financiare njihen në datën në të cilën ato krijohen.

Një aktiv finansiar ose një detyrim finansiar matet në fillim me vlerën e drejtë plus, kostot e transaksionit në rastin e elementeve të përcaktuar jo me VDFH që i ngarkohen drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të tij.

ii. Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Klasifikimi i aktiveve financiare

Në njohjen fillestare, aktivi finansiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDFH. Një aktiv finansiar matet me koston e amortizuar nëse përbush njëkohësisht dy kushtet si më poshtë si edhe nuk është i destinuar si me VDFH:

- mbahet në një model biznesi i cili ka për qëllim të mbajë aktivet për të mbledhur flukset e parasë; dhe
- rrjedha e parasë, lind në data të përcaktuara, sipas kushteve kontraktuale, të cilat janë, vetëm pagesa principali dhe interesit (VPPI).

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)

Të gjitha aktivet e tjera financiare të Fondit maten me VDFH.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Në gjykimin e tij mbi vlerësimin e objektivave të modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv, Shoqeria merr parasysh të gjithë informacionin relevant mbi mënyrën se si biznesi po administrohet duke përfshirë:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesit, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit;
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e kaluara.

Shoqëria ka përcaktuar dy modele biznesi.

Modeli i biznesit mbajtje deri në mbledhje: ky model përfshin paranë dhe ekuivalentet e saj dhe të arkëtueshmet. Këto aktive financiare mbahen në mënyrë që të mblidhen flukset kontraktuale të parasë.

Model tjetër biznesi: kjo përfshin përfshin letrat me vlerë të borxhit dhe investimet e kapitalit. Këto aktive financiare menaxhohen dhe performance e tyre vlerësohet, mbi bazën e vlerës së drejtë, meqenëse shitje të shpeshta të tyre ndodhin në treg.

Riklasifikimet

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e tij të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Në këtë rast të gjithë aktivet financiare që ndikohen, do të riklasifikohen në datën e parë në periudhën e parë raportuese që vijon ndryshimin e modelit të biznesit.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivet financiare me VDFH

Këto aktive financiare maten më pas me vlerën e drejtë. Fitimet ose humbjet neto, duke përfshire të ardhura ose shpenzime nga interesit, ose kurset e këmbimit, njihen në fitim humbje, në të ardhura neto nga instrumentet financiare në VDFH, në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Këto aktive maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesit njihen në të ardhura nga interesit sipas metodës së interesit efektiv, fitim humbjet nga kurset e këmbimit njihen në fitim humbje neto nga kurset e këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje në njohjen fillestare gjithashtu njihet në fitim humbje. Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe të arkëtueshmet përfshihen në këtë kategori.

Detyrimet financiare – Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitim ose humbjet

Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me kosto të amortizuar ose në VDFH. Një detyrim finanziar klasifikohet si VDFH nëse ai klasifikohet si i mbajtur për tregtim, nëse ai është një derivativ ose nësë është i destinuar si i tillë në njohjen fillestare. Detyrimet financiare në VDFH maten me vlerën e drejtë dhe fitim humbjet neto, duke përfshire edhe ndonjë interes, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Detyrime të tjera financiare maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet nga interesat dhe fitim ose humbjet nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga c'regjistrimi njihet po ashtu në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)**Detyrimet financiare me VDFH**

Këto janë instrumente finançiarë të mbajtur për tregtim.

Detyrimet financiare me kosto të amortizuar

Këto janë detyrimet me palë të treta dhe detyrime të tjera.

iii. Matja e vlerës së drejtë

‘Vlera e drejtë’ është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Shoqëria ka qasje në atë datë.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti finançiar duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënavë të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënavë jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyron rëndësinë e përdorimit te faktorëve në këto matje:

- Nivel 1: Faktore që janë të kuotuar me çmime tregu (të parregulluar) në tregje aktive të instrumenteve identike
- Nivel 2: Faktore të tjera nga ato të kuotuar me çmime tregu sipas Nivelit 1, dhe që janë të vëzhgueshem ose drejtpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve) ose jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve të përcaktuara).
- Nivel 3: Faktore që janë të pavëzhgueshëm. Në këtë kategori përfshihen të gjithë instrumentet finançiarë për te cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit.

Instrumentet financiare jo me vlerë të drejtë

Instrumentet financiare që nuk maten me VDFH përfshijnë:

- Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe detyrime të tjera. Këto janë aktive finançiare dhe detyrime finançiare afatshkurtra, vlera kontabël e të cilave është afersisht e njejtë me vlerën e drejtë, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër si edhe cilësinë e lartë të kredisë së tyre.

iv. Matja e vlerës së amortizuar

“Kostoja e amortizuar” e aktiveve finançiare ose detyrimeve finançiare është shuma në të cilën aktivi finançiar ose detyrimi finançiar matet në njohjen fillestare pasi janë zbritur ripagesat e principalit, ose amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për ndonjë diferençë midis vlerës fillestare dhe vlerës në maturim, dhe për aktivet finançiare të rregulluar për ndonjë zhvlerësim.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat kontabël te rëndësishme (vazhdim)

v. Zhvlerësimi

Shoqëria njeh një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK") për aktivet financiare të njoitura me koston e amortizuar. Për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë të rëndësishme që prej njoftes filletare të tij, dhe kur vlerëson HPK, Shoqëria merr parasysh informacionet mbështetëse dhe të arsyeshme dhe që janë relevant dhe të gatshme pa shume kosto dhe pune shtesë. Kjo përfshin analizën të informacionit cilësor dhe sasior, duke u bazuar në historikun dhe eksperiencën e Shoqërisë si edhe duke përfshirë informacione të cilat i përkasin të ardhmes. Shoqëria supozon se rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyre të rëndësishme në rast se ai shfaqet më shumë se 30 dite në vonesë.

Shoqëria konsideron si aktive financiare me rrezik të ulët në rastet kur rreziku i kredisë të kundërpatisë është i listuar si BBB+ nga agjenci të mirënjoitura të vlerësimit si Standard and Poor's, ose kur aktivet financiare lëshohen nga Qeveria Shqiptare ose nga Banka e Shqipërisë.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njojur zhvlerësim për aktivet financiare më 31 Dhjetor 2023.

vi. Ç'regjistrimi

Një aktiv financiar q'regjistrohet kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parashë nga aktivi financiar kanë mbaruar, ose kur Shoqëria transferon të drejtat përmarrë flukset e parashë në një transaksion në të cilin në mënyre të qenësishme të gjitha rreziqet dhe përsitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar ose në të cilin Shoqëria as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur të gjitha rreziqet dhe përsitimet nga pronësia dhe nuk ushton kontroll mbi aktivin financiar.

Në njoftje të një aktivi financiar, ndryshimi midis vlerës së mbartur të aktivit dhe vlerës së dhëne njihet në pasqyrën e fitim humbjes.

c. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë mjete monetare në llogari rrjedhëse në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo më shumë se tre muaj nga data e mbajtjes të cilat mund të jenë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme në vlerën e tregut dhe që përdoren nga Shoqëria në manazhimin e angazhimeve afatshkurtra.

d. Të ardhura dhe shpenzime nga interesë

Të ardhura dhe shpenzime nga interesë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi efektiv llogaritet në njoftjen filletare të një instrumenti financiar si norma që skonton flukset e ardhshme të pagueshme ose të arkëtueshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në:

- vlerën bruto të aktivit financiar; ose
- vlerën me kosto të amortizuar të detyrimit financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesë, metoda e interesit efektiv aplikohet mbi vlerën bruto të aktivit (në rast se aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit financiar.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Shumat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat kontabël të rëndësishme (vazhdim)

e. Aktive afatgjata jomateriale

Program kompjuterik

Licensat për programet kompjuterike të blera kapitalizohen mbi bazën e shpenzimit të bërë për të blerë dhe vënë në përdorim. Markat dhe listat e klienteve të blera gjatë kombinimeve të bizneseve e që kualifikohen për t'u njojur më vete njihen si aktive afatgjata jomateriale me vlerë të drejtë. Norma vjetore e amortizimit duke u bazuar në jetën e dobishme të vlerësuar për programet kompjuterike është 25%.

f. E drejta për të përdorur aktive afatgjata materiale

Qiratë e klasifikuara si qira operative bazuar në SNK 17

E drejta për të përdorur aktivin janë njojur me:

- vlerën e tyre të mbetur sikur SNRF 16 të ishte aplikuar që nga data e fillimit, të skontuara me normën e brendshme të borxhit të Shoqërisë në datën e aplikimit për herë të parë: Shoqëria aplikoi këtë metodë për aktivet me vlerë më të madhe;

Shoqëria përdori disa përjashtime praktike gjatë aplikimit të SNRF 16 tek qiratë të cilat më parë ishin klasifikuar si qira operative sipas SKN 17. Në veçanti Shoqëria përdor këto përjashtime si më poshtë:

- nuk njohu të drejtën për të përdorur aktivin dhe detyrimin për qiranë për ato qira të cilat kishin maturitet më të vogël se 12 muaj që nga data e aplikimit;
- nuk njohu të drejtën për të përdorur aktivin dhe detyrimin për qiranë për ato qira të cilat kishin vlerë të vogël (p.sh. ato kontrata me vlerë më të vogël se 5 mijë Euro ose ekivalenti i tyre në Lek).

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë për aktive me vlerë të ulët

Shoqëria ka përgjedhur të mos njohe të drejtën e përdorimit të asetit për qiratë për të cilët aktivi bazë është me vlerë të ulët dhe qiratë afatshkurtra. Shoqëria i njeh shpenzimet e lidhura me këto qira si shpenzime në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

g. Kapitali i shoqërisë

Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga paratë e kontribuara nga themeluesit e Shoqërisë. Kapitali i Shoqërisë mbahet me vlerën ekivalente në Lek të kontributit të marrë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e kembimit të datës së transaksionit. Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale të tij.

h. Kostot e huamarrjes

Shpenzimet e huamarrjes që janë të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi të kualifikuar, të cilët janë aktive që kërkojnë një periudhë kohe të konsiderueshme për tu bërë gati për qellimin e përdorimit të tyre, i shtohen vlerës së këtyre aktiveve, për aq kohë sa nevojitet që këto aktive të janë gati për përdorimin e parashikuar apo për tu shitur. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në të ardhura dhe shpenzime në perindhën kur ndodhin.

i. Përfitimet e punonjësve

Në rrjedhën normale të biznesit Shoqëria, kryen pagesa me emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar në sigurime shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme sipas legjislacionit lokal. Kostot e ndodhura nga ana e Shoqërisë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat kontabël të rëndësishme (vazhdim)

j. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative njihen mbi bazën e kontabilitetit me të drejtë të konstatuara kur ato ndodhin.

k. Tatimi mbi fitimin aktual dhe tatimi mbi fitimin i shtyrë

Shpenzimet për tatinin mbi fitimin përfshijnë tatinin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimet për tatinin mbi fitimin njihet në të ardhura dhe shpenzime përvèç se kur ai i referohet zérave të njohura direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi i pritur i pagueshëm mbi fitimin e pagueshëm të viti, duke përdorur normat tatimore të miratuara apo të miratuara në masë substanciale në datën e bilancit, dhe ndonjë rregullim të tatim fitimit të pagueshëm lidhur me vitin e mëparshëm. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% mbi fitimin e tatushëm.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke krijuar provigion për diferençat e përkohshme midis bazës tatimore dhe vlerave të mbeturat të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen ndaj diferençave të përkohshme kur ato rimerren, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi apo që do të hyjë më vonë në fuqi përgjatë periudhës së rimartjes.

Një aktiv tatimore i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatushme do të janë të vlefshme kundrejt të cilave diferençat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen në masën që përfitimet tatimore në lidhje me to janë të mundshme të realizohen.

l. Provigionet

Provigionet njihen atëherë kur: Shoqëria ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara; ka shumë mundësi që një reduktim burimesh do të jetë i nevojshëm për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të vlerësohet me besueshmëri.

m. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura përfshijnë aksionerët dhe drejtorët e shoqerisë, së bashku me entitete që ato kontrollojnë, te cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e Shoqerisë. Duke konsideruar çdo palë të tretë të mundshme vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

n. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese përvèç rasteve kur mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguesekur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigion nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme konfirmojnë provigionin, një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

o. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit të cilat vënë në dispozicion informacion shtesë mbi pozicionin e Shoqerisë në datën e pasqyrave të pozicionit financiar (ngjarje irregulluese), reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit të cilat nuk janë ngjarje irregulluese, paraqiten në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

4. Gjykimet kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqerisë të cilat paraqiten në shënimin 3, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësish të dukshme nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjera që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndyshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen rregullisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet, nëse rishikimi ndikon vetëm në periudhën që rishikimohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse rishikimi ndikon në periudhen aktuale dhe në atë të ardhshme.

Pasiguri në gjykim

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet në masën që vlera kontabel e aktivit e tejkalon shumen e tij të rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset monetare nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë të përshtatshme të interesit kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në çdo datë të pasqyrës të pozicionit finanziar. Drejtimi gjykon që jeta e përcaktuar e dobishme të aktiveve përfason dobinë e pritshme të aktiveve. Vlerat e mbartura të këtyre aktiveve janë analizuar në shënimin 9. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndyshojnë për shkak të daljeve jashtë përdorimit nga ndryshimet teknologjike.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria rregullisht teston për zhvlerësim të arkëtueshmet e saj. Gjatë kryerjes së këtyre testimeve shoqëria merr parasysh pagesat e rregullta të bera, pra debitorin, pozicionin e tij finanziar dhe operacionet, arkëtueshmërinë e pagesave nga instrumentet financiare dhe një numer kriteresh të tjera të përdorura përkëtuar vlerësim.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare: në përcaktimin e inputeve të modelit HPK (humbjes së pritshme të kredisë) duke përfshirë informacione të ardhshme.

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënim shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar

a. Kuadri për administrimin e rrezikut financiar

Shoqëria investon në instrumente financiare në përpunhje me strategjinë e tij të investimit. Portofoli i investimit përfshin depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Kështu Shoqëria është e ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve nga instrumentet financiare:

- rreziku i kredise;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i tregut; dhe
- rreziku operacional.

b. Rreziku i kredise

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërise nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ.

Politika e Shoqërisë mbi rrezikun e kredisë është minimizimi i ekspozimit të tij ndaj palëve të cilat janë të përceptuara si me rrezik të lartë ës, dhe të ketë marrëdhënie vetëm me palë të cilat përbushin standarde e kredisë sipas politikes së investimit të Shoqërisë.

Rreziku i kredisë për investimet në depozita me afat me banka është vlerësuar si i ulët krahasuar me investime të tjera.

Aktivet financiare detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paraja dhe ekuivalente të saj	1,367,911	89,834
Të arkëtueshme nga Fondet	1,264,197	821,935
Të arkëtueshme të tjera	3,087,786	4,150,000
Investime të mbajtura deri në maturim	30,000,000	30,000,000
Totali	35,719,894	35,061,769

c. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet e tij ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme.

Politika e Shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvëç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut finansiar (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit të tyre më 31 dhjetor 2023 janë si vijon:

Aktivet	31 dhjetor 2023	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	>5 vjet
Paraja dhe ekuivalente të saj	1,367,911	1,367,911	-	-	-	-	-
Të arketuëshme nga Fondet	1,264,197	1,264,197	-	-	-	-	-
Të arkëtueshme të tjera	3,087,786	3,087,786	-	-	-	-	-
Investime të mbajtura deri ne maturim	30,000,000	-	-	-	-	-	30,000,000
Total	35,719,894	5,719,894	-	-	-	-	30,000,000
Detyrime							
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	4,049,133	4,049,133	-	-	-	-	-
Totali	4,049,133	4,049,133	-	-	-	-	-
Pozicioni neto	31,670,761	1,670,761	-	-	-	-	30,000,000

Aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit të tyre më 31 dhjetor 2022 janë si vijon:

Aktivet	31 dhjetor 2022	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	>5 vjet
Paraja dhe ekuivalente të saj	89,834	89,834	-	-	-	-	-
Të arketuëshme nga Fondet	821,935	821,935	-	-	-	-	-
Të arkëtueshme të tjera	4,150,000	4,150,000	-	-	-	-	-
Investime të mbajtura deri ne maturim	30,000,000	-	-	-	-	-	30,000,000
Total	35,061,769	5,061,769	-	-	-	-	30,000,000
Detyrime							
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	2,223,626	2,223,626	-	-	-	-	-
Totali	2,223,626	2,223,626	-	-	-	-	-
Pozicioni neto	32,838,143	2,838,143	-	-	-	-	30,000,000

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënim shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut finanziar (vazhdim)**d. Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut zhvillohet si pasojë e ndryshimeve në:

- a) normat e interesit,
- b) kurset e këmbimit.

Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së instrumentit finanziar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së instrumentit finanziar.

Luhatjet e kursit të këmbimit sjellin luhajte edhe të vlerës së aktiveve të konvertuar në monedhën vendase, Lek. Shoqeria nuk ka parashikuar të shpërndajë asete në valutë të huaj.

Aktivet dhe detyrimet financiare sipas monedhës së tyre më 31 dhjetor 2023 janë si vijon:

Aktivet	Në Lek	Në EUR	Totali
Paraja dhe ekuivalentë të saj	1,220,422	147,489	1,367,911
Të arketueshme nga Fondet	1,264,197	-	1,264,197
Të arketueshme të tjera	3,087,786	-	3,087,786
Investime të mbajtura deri në maturim	30,000,000	-	30,000,000
Totali	35,572,405	147,489	35,719,894
Detyrime			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	4,049,133	-	4,049,133
Totali	4,049,133	-	4,049,133
Pozicioni neto	31,523,272	147,489	31,670,761

Aktivet dhe detyrimet financiare sipas monedhës së tyre më 31 dhjetor 2022 janë si vijon:

Aktivet	Në Lek	Në EUR	Totali
Paraja dhe ekuivalentë të saj	78,044	11,790	89,834
Të arketueshme nga Fondet	821,935	-	821,935
Të arketueshme të tjera	4,150,000	-	4,150,000
Investime të mbajtura deri në maturim	30,000,000	-	30,000,000
Totali	35,049,979	11,790	35,061,769
Detyrime			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	1,651,758	571,868	2,223,626
Totali	1,651,758	571,868	2,223,626
Pozicioni neto	33,398,221	(560,078)	32,838,143

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Shënim shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut finanziar (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndikimin mbi pozicionin neto në Lek si pasojë e ndryshimit në kurset e këmbimit me 5% për aktivet dhe detyrimet financiare në EUR:

Skenari	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
	Efekti ne fitim/(humbje)		Efekti ne fitim/(humbje)	
+/- 5%		7,374		(28,004)

e. Rreziku operacional

‘Rreziku operacional’ është rreziku i pësimit të një humbjeje direkte ose jo-direkte që mund të lindë si pasojë e një sërë shkaqesh që shoqërojnë procese të tillë si teknologjia dhe infrastruktura që mbështet veprimtarinë e Shoqërisë me instrumentet financiare, qoftë së brendshmi në Shoqëri apo së jashtmi me ata që i ofrojnë shërbime Shoqërisë, dhe nga faktorë të jashtëm të tjerë nga rreziku i kredisë, i tregut apo i likuiditetit, të tillë si ato që lindin nga kërkесat ligjore dhe rregullatorë dhe standartet e gjithë pranuara të sjelljes së investimeve.

Qëllimi i Shoqërisë është të administrojë rrezikun operacional në mënyrë të tillë që të barazpeshojë kufizimet në humbje financiare dhe dëmtimit të reputacionit me arritjen e qëllimit të investimeve për të prodhuar kthim ndaj investitorëve.

f. Administrimi i kapitalit

Shoqëria është subjekt i kërkësave rregullatore për kapital sipas kërkësave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”), bazuar në Ligjin numër 56/2020 datë 30 prill 2020 “Për Shoqëritë e Investimeve Kolektive” dhe rregullores nr. 132, datë 30 shtator 2020 “Për formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë detyrimisht Shoqëria Administruese e Fondeve”.

6. Paraja dhe ekuivalentë të saj

Paraja dhe ekuivalentë të saj maten me koston e amortizuar në pasqyrat financiare dhe përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Llogari rrjedhëse në bankë	1,367,911	89,834
Totali	1,367,911	89,834

7. Të arkëtueshme nga Fondet

Të arkëtueshme nga Fondet është shuma për t'u marrë nga Fondi i Investimit dhe Fondi i Pensionit më 31 dhjetor 2023 dhe përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fondi i Pensionit	1,037,944	652,278
Fondi i investimit	204,888	169,657
Fondi i Pensionit Smart	21,365	-
Totali	1,264,197	821,935

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shëniue shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

8. Të arkëtueshme të tjera

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2023 përbëhen nga shuma të arkëtueshme nga Albsig Jetë sh.a si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Albsig Jetë sha	3,087,786	4,150,000
Totali	3,087,786	4,150,000

9. Shpenzime të parapaguara

Shpenzimet e parapaguara më 31 dhjetor 2023 përbëhen nga shuma të arkëtueshme nga Albsig Jetë sh.a si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Parapagim Primera	839,860	839,860
Totali	839,860	839,860

Shpenzime të parapaguara përfaqëson parapagimin pranë sistemit operativ Primera. Shuma përfaqëson ekivalentin 7.000,00 Euro të konvertuar në lekë. Në përfundim të shtimit të modulit, i cili akoma nuk është konkretizuar, kjo shumë do të kontabilizohet si investim në aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

10. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto

	Software	Totali
Kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2021	7,514,000	7,514,000
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	7,514,000	7,514,000
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	7,514,000	7,514,000
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 31 dhjetor 2021	3,244,125	3,244,125
Amortizimi për periudhën	1,878,500	1,878,500
Gjendja më 31 dhjetor 2022	5,122,625	5,122,625
Amortizimi për periudhën	1,878,500	1,878,500
Gjendja më 31 dhjetor 2023	7,001,125	7,001,125
Vlera e mbetur neto		
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,391,375	2,391,375
Gjendja më 31 dhjetor 2023	512,875	512,875

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvëç nëse shprehet ndryshe)

11. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2023 janë si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Investime	30,000,000	30,000,000
Totali	30,000,000	30,000,000

Investime të mbajtura deri në maturim paraqesin obligacionet qeveritare të blera me maturim 10 vjeçar dhe janë për tu mbajtur deri në maturim.

12. Të pagueshme tregtare dhe të tjera

Të pagueshme dhe detyrime të tjera janë si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paga të pagueshme	1,257,605	384,611
Kontribute të sigurimeve shoqërore	682,720	218,051
Taksa të pagueshme	135,532	375,022
Të pagueshme ndaj AMF	-	37,392
Të tjera	1,973,276	1,208,550
Totali	4,049,133	2,223,626

13. Kapitali

Albsig Invest sh.a., është një shoqëri aksionare, e krijuar më tetor 2019, dhe e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”) me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019.

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2023 është 69,000,000 Lek (31 dhjetor 2022: 69,000,000 Lek).

Aksionet e Shoqërisë zotërohen 100% nga aksioneri i saj i vetëm Albsig Jetë sha.

	Numri i aksioneve	Vlera	% totali
Albsig Jetë sha	69,000	69,000,000	100%
Totali	69,000	69,000,000	100%

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shëni me shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

14. Të ardhura nga tarifa e administrimit

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Tarifa nga Fondi i Pensionit	9,729,177	5,906,035
Tarifa nga Fondi i Investimit	2,311,971	2,287,598
Të ardhura nga tarifa e largimit nga foni	1,095,375	644,891
Tarifa nga Fondi i Pensionit Smart	161,795	-
Totali	13,298,318	8,838,524

15. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera përfaqësojnë të ardhurat nga shërbimet e konsulencës për palët e lidhura të shoqerisë.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura të tjera	5,875,270	11,150,000
Totali	5,875,270	11,150,000

Të ardhurat e tjera në shumën 5,875,270 Lek paraqesin të ardhura të realizuara gjatë vitit 2023 per shërbime konsulencë ofruar Albsig Jete sha.

16. Shpenzime për personelin

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paga	16,122,755	14,884,600
Kontributë të sigurimeve shoqërore	1,322,381	1,067,740
Pension vullnetar	1,000,746	506,996
Shpenzime të tjera personeli	270,000	270,000
Totali	18,715,882	16,729,336

17. Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative janë si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime mirëmbajtjeje	1,693,116	1,718,412
Shpenzime për auditimin	262,680	139,956
Taksa bashkiake	74,500	74,500
AMF	184,481	253,883
Shpenzime për komunikim	114,360	118,358
Banka depozitare	679,921	401,610
Qira	360,000	360,000
Anëtarësime	8,800	8,800
Komisione agjenti	8,952	-
Shpenzime për veprime	71,563	51,098
Të tjera	20,000	29,600
Totali	3,478,373	3,156,217

ALBSIG INVEST SHA**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për periudhën që mbylljet më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)

18. Shpenzime financiare/(të ardhura), neto

Shpenzimet financiare/(të ardhura), neto janë si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
(Fitim)/humbje nga kurset e këmbimit	(269,406)	(47,652)
Komisione bankare	30,137	46,809
Të ardhura nga interesë	(1,614,016)	(1,617,624)
Totali	(1,853,285)	(1,618,467)

19. Tatimi mbi fitimin

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Humbja përpara tatimit	(3,045,882)	(157,062)
Shpenzime të panjohura	-	-
Humbja para tatimit	(3,045,882)	(157,062)
Tatimin mbi fitimin 15%	-	-
Humbja pas tatimit	(3,045,882)	(157,062)

20. Palët e lidhura

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të arkëtueshme të tjera Albsig Jetë sha	3,087,786	4,150,000
Të ardhura të tjera Albsig Jetë sha	5,875,270	11,150,000
Të pagueshme për qiranë Albsig sha	1,110,000	750,000
Shpenzime qiraje Albsig sha	360,000	360,000

21. Ngjarje mbas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.